



# PËRGJEGJËSIA SOCIALE


**"Banka Amerikane e Investimeve"-ABI BANK investon në përmirësimin e kushteve të "Qendrës së Riintegritit për viktimat e trafikimit" dhe "Alternativave të përkujdesjes së fëmijëve të viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje".**

Për organizatën tonë konsiderohet e rëndësishme që kompanitë ose bizneset të njohin dhe të përqafojnë përgjegjësinë sociale në mbështetje të personave të cilët janë përballur me një nga sfidat më të rënda të shoqërisë shqiptare; trafikimin.

"Different & Equal" në kuadrin e programit të riintegritit, i ofron çdo përfitueseje një paketë shërbimesh në përputhje me nevojat, e cila përfshin: strehim, ushqim dhe veshmbathje, siguri dhe plan riintegriti, asistencë mjekesore, këshillim psikologjik, negociim/ndërmjetesim me familjen, mbështetje dhe ndihmë ligjore, aktivitete sociale, asistencë për regjistrim/vazhdimësi në edukimin shkollor, trajnime profesionale dhe punësim, monitorim dhe ndjekje të mëtejshme, mbështetje për riintegrim për jetën sociale, strehim/kujdes alternativ, mbështetje financiare për strehim.



Banka Amerikane e Investimeve (ABI Bank) në kuadër të programeve të saj të mbështetjes sociale bëri të mundur të kontribuohet në zëvendësimin e mobiljeve të amortizuara me ato të reja, në ambjentet e "Qendrës së Riintegritit" dhe "Alternativat e përkujdesjes së fëmijëve të viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje". Ky projekt konsiston në sigurimin e një mjedisi më tërheqës në përputhje me Standardet Kombëtare të Kujdesit për viktimat e trafikimit. Gjithashtu fëmijët e dy prej qendrave Alternative për përkujdesjen e fëmijëve në Shkodër dhe Shkozë do kenë mundësi të marri shërbimin në një ambient të pajisur me sistem më të avancuar ngrohjeje.



Përmirësimi i infrastruktures për këtë kategori mundëson kushte më të favorshme për realizimin e aktiviteteve si dhe kontribuon në rritjen e mirëqënies emocionale dhe psikologjike. Ofrimi i kushteve në standartet më optimale të mundshme i jep mundësinë këtij komuniteti të marginalizuar i cili vjen nga rrethana të vështira të ndihen të përkrahur në çdo aspekt. Përtej shërbimeve multidimensionale të ofruara nga organizata jotë, angazhimi i Bankës Amerikane të Investimeve është një shembull i mirë biznesi i cili mbart vlerat e një institucioni të përgjegjeshëm në raport me shoqërinë dhe grupet e marginalizuara.